

Mynih, 31 Maj 2025

Njoftim për pozicion të lirë pune

Në zbatim të kërkesave të Institutit të Indoevropianistikës së Krahastuar dhe të Albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut (LMU), ky institut shpall pozicionin për vend të lirë pune:

1. Pozicioni: Lektor me kohë të pjesshme (35%), me datë fillimi 1 Tetor 2025, pranë Institutit të Indoevropianistikës së Krahastuar dhe të Albanologjisë, LMU, Mynih

Kandidati/ja që aplikon për vendin e lektorit, pranë Institutit të Indoevropianistikës së Krahastuar dhe të Albanologjisë, duhet të plotësojë kriteret që janë parashtruar në këtë dokument:

A. Kriteret

Kandidati/ja:

1. Të ketë gradën Master në degët e Albanologjisë, si për shembull Gjuhë-Letërsi Shqipe, Gjuhësi, Letërsi ose në ndonjë degë të ngjashme a të përafërt.
2. Të njohë në nivel amtar ose shumë mirë shqipen e folur dhe të shkruar, si dhe të zotërojë dhe të ketë dëshmi përkatëse për njohjen e gjermanishtes ose të anglishtes.
3. Të ketë të paktën 2 (dy) vjet përvojë në mësimdhënien e shqipes si gjuhë e huaj dhe si gjuhë e trashëgimisë në nivelin universitar.
4. Të ketë përvojë në mësimdhënien e 1 (një) lënde në nivelin universitar në fushën e Albanologjisë ose fushave të ngjashme.

B. Dokumentet që duhet të dorëzojë kandidati/ja:

Kandidati duhet të dërgojë me postë elektronike, me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë Institutit të Indoevropianistikës së Krahastuar dhe të Albanologjisë (LMU), dokumentet e dosjes së tij personale si më poshtë:

1. Letër motivimi, me të cilën kandidati tregon arsyet e kandidimit dhe nivelin e përgatitjes së tij për pozicionin e shpallur në konkurrim.
2. Curriculum Vitae, me të dhënat personale e profesionale (ku të përfshihet aktiviteti mësimdhënës e shkencor).
3. Evidenca që dëshmojnë kualifikime dhe vlerësime për mësimdhënien.
4. Një punim kërkimor-shkencor, përfaqësues i programit kërkimor-shkencor personal të kandidatit/kandidates

C. Afati i dorëzimit të dokumenteve

Pranimi i dokumenteve (të mbledhura në një dokument të plotë, me përjashtim të punimit kërkimor-shkencor) bëhet deri më datën 15 korrik 2025 tek adresa elektronike sprachwiss@lrz.uni-muenchen.de ose tek adresa postare e përcaktuar më lart.

Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë të drejtën të konsultohen me njësinë përgjegjëse të personelit për plotësimin e dokumentacionit, Znj. Barbara Epple, E-mail: sprachwiss@lrz.uni-muenchen.de.